

Probabiliteti për astmë në vlerësimin fillestar klinik

Simptomat episodike

Më shumë se një prej simptomave të fishkëllimës, marrjes së frymës, shtrëngimit në gjoks dhe kollitjes që shfaqen në mënyre episodike me periudha me dhe pa simptoma apo me simptoma minimale ndërmjet episodeve.

- Histori e dokumentuar e atakeve të fishkëllimave akute të shkaktuara nga infeksioni viral ose ekspozimi ndaj alergjenëve me përmirësim simptomatik dhe objektiv me kalimin e kohës dhe/ose me trajtimin për astmë;
- Episode të simptomave që shfaqen herë pas here të shkaktuara nga ekspozimi ndaj alergjenëve dhe infeksioni viral të përkeqësuar nga aktiviteti fizik, ajri i ftohtë, emocioni apo e qeshura të fëmijët;
- Të të rriturit, simptomat shpërthejnë nga marrja e medikamenteve antiinflatore josteroidale dhe ose i beta bllokuesve;
- Historiku i dokumentuar i niveleve jashtëzakonisht të ulëta të FEV1 ose PEF gjatë episodeve simptomatike krahasuar me periudhat asimptomatike, konfirmon në mënyrë krejt objektive natyrën bllokuese të simptomave episodike.

Fishkëllima e konfirmuar nga një profesionist i kujdesit shëndetësor gjatë auskultimit

Ka shumë rëndësi të dallojmë fishkëllimat nga format e tjera të zhurmave respiratore, si stridor.

Ekzaminimi normal i përsëritur i kraharorit të simptomatikëve ul probabilitetin e astmës.

Evidenca për variacion gjatë 24 orëve

Simptoma që përkeqësohen gjatë natës ose në orët e para të mëngjesit..

Histori me gjendje atopie

Anamnezë personale për atopi (p.sh. ekzema e rinitit alergjik), ose anamnezë familjare për astmë dhe/ose gjendje atopike, me shumë gjasa të konfirmuara nga dokumentimi i mëparshëm i rritjes së nivelit të IgE-ve specifike ndaj alergjeneve, i testeve alergjike të lëkurës pozitive ndaj alergjenëve të ajrit ose rritje të eozinofileve në gjak.

Mungesa e simptomave, shenjave ose historisë klinike që sugjeron diagnoza të tjera

(përfshin por nuk kufizohet vetëm te SPOK-u, çrregullim i funksionit të frymëmarrjes, obezitet)